

Commonwealth Ombudsman

Ombudsmani i Komonuelthit (Mbledhësi i Ankesave të popullit) është një person i pavarur që heton ankesat e bëra në drejtim të departamenteve të Qeverisë Australiane.

FUNKSIONI I OMBUDSMANIT

Ombudsmani mund të hetojë ankesa në lidhje me shumicën e agjencive të Qeverisë Australiane, duke përfshirë Centrelink, Zyrën e Taksave, Agjencinë e Child Support (Përkrahjes së Fëmijëve), Departamentin e Emigracionit si dhe Postën e Australisë.

Është në dorë të Ombudsmanit të vendosë nëse një veprim apo vendim në shqyrtim është i gabuar, i paarsyeshëm, i padrejtë apo diskriminues. Ai gjithashtu ka të drejtë të hetojë ndonjë vonesë ose mungesën e veprimit të administratës.

Nga ana tjetër, Ombudsmani nuk mund të hetojë ankesat në lidhje me personat privatë ose kompanitë, vendimet e gjykatave, apo veprimet ose vendimet e shtetit apo qeverisë lokale, të ministrave të qeverisë ose të disa ndërmarrjeve shtetërore biznesi.

Ombudsmani është i paanshëm dhe i përkushtohet arritjes së një rezultati të drejtë.

Ombudsmani punon për të përmirësuar administratën publike me qëllim që të parandalojë përsëritjen e problemeve.

FUQITË E OMBUDSMANIT

Ombudsmani ka fuqi të zgjeruara për hetimin e ankesave, duke përfshirë fuqinë për të urdhëruar zyrtarët që t'i dorëzojnë dokumentat ose që t'i përgjigjen pyetjeve.

Nëse Ombudsmani gjen një defekt në administratë, ai mund të rekomandojë që agjencia përgjegjëse ta korrigjojë atë ose i ofron një zgjidhje.

Për shembull, ai mund të rekomandojë që departamenti në fjalë të japë një shpjegim ose të kërkojë të falur, të përshtasë ose të ndryshojë një vendim, të falë një borxh ose të paguajë një dëmshpërblim.

SI TË BËNI NJË ANKESË

Përpara se të kontaktoni zyrën e Ombudsmanit, duhet të përpiqeni ta zgjidhni problemin duke kontaktuar administratën e agjencisë për të cilën keni ankesë, veçanërisht shërbimin e tyre të ankesave nëse e kanë të vlefshëm. Nëse ankoheni për një vendim, përpara duhet të kërkonit rishikim të atij vendimi, nëse është e mundur.

Përpara se të kontaktoni zyrën e Ombudsmanit, duhet të përpigjeni ta zgjidhni problemin duke kontaktuar administratën e agjencisë për të cilën keni ankesë, veçanërisht shërbimin e tyre të ankesave nëse e kanë të vlefshëm. Nëse ankoheni për një vendim, përpara duhet të kërkonit rishikim të atij vendimi, nëse është e mundur.

Ombudsmani ka zyra në kryeqytetet e të gjithë Shteteve dhe Territorit. Ju mund të bëni një ankesë në person, ose duke telefonuar, me letër, fax ose e-mail.

Ju gjithashtu mund të thërrisni Ombudsmanin për koston e një thirrje lokale në numrin **1300 362 072**.

Për të bërë një ankësë në emrin tuaj ju mund të autorizoni edhe dikë tjetër, një shok, një të afërm apo një punonjës komuniteti.

Njerëzit nga prejardhje jo-Anglisht folëse që dëshirojnë të kontaktojnë Zyrën e Ombudsmanit mund ta bëjnë një gjë të tillë nëpërmjet Translation and Interpreting Service (TIS) (Shërbimi i Përkthimeve) duke telefonuar në numrin **131 450** ose mund ta bëjnë lutjen me shkrim në gjuhën e tyre.

SHËRBIM KONFIDENCIAL DHE FALAS

Hetimet e ankesave janë të fshehta dhe ky shërbim është falas.

Ju keni të drejtë të ankoheni

Ky informacion është vetëm një udhëzues. Për më shumë informacion kontaktoni Ombudsmanin e Komonuelthit.

NA KONTAKTONI NE

Ju mund të kontaktoni zyrën më të afërt të Ombudsmanit të Komonuelthit për koston e një thirrje lokale duke telefonuar:

National Complaints Line (Linjën Kombëtare të Ankesave) – **1300 362 072**

(Shënim: Thirrjet nga telefonat e dorës do të faturohen sipas tarifave përkatëse.)

Email ombudsman@ombudsman.gov.au

Web www.ombudsman.gov.au

ZYRAT E OMBUDSMANIT TË KOMONUELTHIT

ADELAIDE

Tel 1300 362 072
Fax 08 8226 8618
Level 5, 50 Grenfell Street
Adelaide SA 5000

MELBOURNE

Tel 1300 362 072
Fax 03 9867 3750
Level 1
441 St Kilda Road
Melbourne VIC 3004

BRISBANE

Tel 1300 362 072
Fax 07 3229 4010
Level 17, 53 Albert Street
Brisbane QLD 4000

PERTH

Tel 1300 362 072
Fax 08 9221 4381
PO Box Z5386
St Georges Terrace
Perth WA 6831
Level 12, St Martin's Tower
44 St Georges Terrace
Perth WA 6000

CANBERRA & NATIONAL OFFICE

Tel 1300 362 072
Fax 02 6249 7829
GPO Box 442
Canberra ACT 2601

Ground Floor, 1 Farrell Place
Canberra City ACT 2600

SYDNEY

Tel 1300 362 072
Fax 02 9211 4402
PO Box K825
Haymarket NSW 1240

DARWIN

Tel 1300 362 072
Fax 08 8941 5400
GPO BOX 1344, Darwin NT 0801

Level 12, NT House
Cnr Bennett & Mitchell Streets
Darwin NT 0801

Level 7, North Wing
Sydney Central
477 Pitt Street
Sydney NSW 2000

HOBART

Tel 1300 362 072
Fax 03 6233 8966
GPO Box 960
Hobart Tas 7001

Ground Floor
99 Bathurst Street
Hobart TAS 7000

Shërbimet e vlefshme për t'ju ndihmuar që të bëni një ankesë

Nëse nuk flisni mirë Anglisht, ne mund t'ju ndihmojmë nëpërmjet

Translating and Interpreting Service (Shërbimi të Përkthimeve) (TIS) në numrin **131 450**.

Nëse jeni shurdh, qorr apo memec **Shërbimi TTY** është i vlefshëm nëpërmjet **National Relay Service** në numrin **133 677**.